FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

UDHËZUES PËR ORGANIZIMIN E TURNEUT FINAL TË KUPËS SË KOSOVËS

Kosovo Basketball Federation, Lagja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000 Prishtina Kosovo.
www.basketbolli.com email: info@basketbolli.com tel: +381 38 704 101; mob: 00386 49 738 080

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Përmbajtja

1 Dispozitat e Përgjithshme.....3
1.1 Hyrje.....3
1.2 Obligimet e FBK-së.....3
1.3 Obligimet organizatorit.....3
1.4 Procedura e garimit.....3

2. Struktura organizative.....4
2.1 Formimi i Këshillit Organizativ.....5
2.2 Personat tjerë të angazhuar në Turne Final.....5
2.3 Personat zyrtarë të FBK-së të përfshirë në organizim.....5
2.4 Obligimet ndaj shërbimeve emergjente dhe të sigurisë.....5

3. Salla.....6
3.1 Zhveshtoret.....6
3.2 Tavolina zyrtare.....6
3.3 Zyrat.....7
3.4 Tribuna VIP.....7
3.5 Vendet e rezervuara për ekipet pjesëmarrëse.....7

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

3.6 Tribuna për gazetarë.....7
3.7 Press qendra.....8

4. Akreditimet dhe biletat.....9

5. Ceremonia e hapjes dhe e mbylljes së Turneut Final.....9
5.1 Ceremonia e hapjes së Turneut Final.....9
5.2 Ceremonia e mbylljes së Turneut Final.....9

6 Marketingu dhe promocioni.....10
6.1 Brandingu i sallës.....11

7Mediat.....12
7.1 Konferencat për shtyp.....12
7.2 Broshura e Turneut Final.....12

1. Dispozitat e përgjithshme

1.1 Hyrje

Nëpërmjet këtij udhëzuesi definohen kërkesat dhe kriteret themelore për organizimin e Turneut Final të Kupës së Kosovës në basketboll. Të drejtën për organizmin e Turneut Final të Kupës së Kosovës në Basketboll (në tekstin e mëtejmë Turneu Final) e ka Federata e Basketbollit e Kosovës (në tekstin e mëtejmë FBK). FBK mban të drejtën që të

shpallë konkurs dhe të japë të drejtën e organizimit të Turneut Final subjekteve juridike që plotësojnë kushtet që saktësohen në këtë udhëzues, Propozicionet e Garave të Kupës së Kosovës dhe akteve tjera normative të FBK-së.

Subjekti që e fiton të drejtën e organizimit të Turneut Final nënshkruan kontratë me FBK-së ku precizohen të drejtat dhe obligimet e organizimit të Turneut Final.

Gjatë tërë procesit të organizimit dhe zhvillimit të Turneut Final në plotësi duhet zbatuar rregulloret dhe aktet përkatëse normative të FBK-së dhe FIBA-s.

1.2 Obligimet e FBK-së

FBK do të bëjë të gjitha përpjekjet brenda mundësive të saj që të sigurojë organizim të nivelit më të lartë të Turneut Final. FBK do të bëjë monitorimin e organizimit dhe do të ndërhyjë në organizim me qëllim të parandalimit të problemeve ose vështirësive eventuale.

1.3 Obligimet e organizatorit

Organizatori është i obliguar që ti përmbushë të gjitha kërkesat dhe obligimet që dalin nga ky udhëzues dhe kontrata e nënshkruar me FBK-në. Organizatori obligohet që të caktojë një person kontaktues, i cili do të jenë në dispozicion dhe në shoqëri të njerëzve përgjegjës të FBK-së para dhe gjatë Turneut Final të Kupës.

1.4 procedura e garimit

Në turneun final marrin pjesë katër ekipe në konkurrencën e meshkujve dhe dy ekipe në konkurrencën e femrave.

Çiftet e gjysmëfinaleve të meshkujve dhe çifti final i femrave përcaktohen në Propozicionet e Garave të Kupës. Në rast se propozicionet parashohin hedhje të shortit, kjo procedurë do të merret përsipër nga organizatori i Turneut Final dhe në të do të ftohen përfaqësuesit e të gjitha klubeve të përfshira në short dhe zyrtarët e FBK-së.

Organizatori është i obliguar që së paku 72 ora para fillimit të turneut final të publikojë oraret e zhvillimit të ndeshjeve. Ndeshjet duhet te zhvillohen në termine të parapara në Propozicione të Garave.

Organizatori është i obliguar që të sigurojë termine për stërvitje në sallën ku zhvillohet ndeshja, më së largu 24 orë para fillimit të ndeshjes, për të gjitha ekipet pjesëmarrëse që bëjnë kërkesë me shkrim për termin për stërvitje.

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Kërkesa duhet të bëhet jo më vonë se 72 orë para zhvillimit të ndeshjes së parë. Në rast se më shumë se një ekip kërkon termin për stërvitje, alokimi i termineve do të bëhet sipas parimit "i pari luan – i pari stërvit".

Terminet për stërvitje duhet të caktohen sipas parimit "stërvit kur luan". Nuk preferohet dallim më i madh se një orë ndërmjet terminit të stërvitjes dhe terminit të fillimit të ndeshjes.

Organizatori për çdo ndeshje është i obliguar që, për të gjitha ekipet pjesëmarrëse, në të gjitha stërvitjet ose ndeshjet e Turneut Final, të sigurojë:

- zhveshtoret
- së paku 6 topa të lojës
- sasi të mjaftueshme të ujit (së paku 18 shishe 1,5l me ujë për lojtarë dhe 6 shishe 0,5l për shtab teknik)
- sasi të mjaftueshme të akullit

2 Struktura Organizative

2.1 Formimi i Këshillit Organizativ

Me të fituar të drejtën e organizimit të Turneut Final, organizatori është i obliguar që të themelojë Këshillin Organizativ, që duhet të jetë në kontakt të vazhdueshëm me FBK-në. Këshilli Organizativ (në tekstin e mëtejmë KO) duhet të përmbajë edhe njerëzit përgjegjës në këto poste:

Menaxheri i Turneut (Event Manager) – njeriu përgjegjës që duhet të dijë të gjitha detajet e organizimit, ka të drejtë të vendimmarrjes së menjëhershme për çështje organizative dhe është personi primar kontaktues me FBK-në. Menaxheri i Turneut merr përsipër kompetencat dhe detyrat e anëtarëve të tjerë te KO, në rast se ato nuk janë të precizuara mirë ose nuk kryhen me përgjegjësi.

Menaxheri i IT-së – njeriu përgjegjës për të gjitha pajisjet e teknologjisë informative dhe infrastrukturës teknike në sallë. Menaxheri i IT-së vë në dispozicion dhe mban përgjegjësi për kualitetin e internetit, kompjuterëve, pajisjeve të zërimit dhe të gjitha pajisjeve tjera teknike në sallë.

Zëdhënësi – njeriu përgjegjës për marrëdhënie me mediat. Zëdhënësi po ashtu bën edhe hapjen dhe moderimin e konferencave për media gjatë Turneut Final dhe është përgjegjës për akreditimin e pjesëtarëve të mediave që mbulojnë Turneun Final.

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Përgjegjësi për marketing (Marketing Manager) – njeriu përgjegjës për zbatimin e dispozitave të marketingut të Turneut Final në sallë dhe njeriu përgjegjës për shpërndarjen e materialit të marketingut për media, me theks të veçantë për televizionin që bën transmetimin e drejtpërdrejtë të ndeshjeve.

Komesari për Siguri (Security Officer) – njeriu përgjegjës për sigurinë përgjatë tërë rrjedhës së Turneut Final. Komesari për Siguri është përgjegjës edhe për komunikimin me organet e sigurisë para dhe gjatë Turneut Final dhe obligohet që ti përmbahet të gjitha ligjeve dhe udhëzimeve për parandalimin dhe dhunës dhe huliganizmit në terrene sportive.

Përgjegjësi i Sallës (Venue Manager) – njeriu përgjegjës për infrastrukturë dhe njeriu që posedon informatat dhe qasjen në të gjitha pjesët e sallës ku zhvillohet Turneu Final.

Organizatori duhet ta deponojë organogramin dhe emrat e personave përgjegjës me telefona dhe emaile kontaktuese të KO më së voni 7 ditë para fillimit të Turneut Final. Organorgrami dhe emrat e personave përgjegjës duhet të jenë pjesë e aplikacionit.

2.2 Personat tjerë të angazhuar në Turne Final

Me qëllim të organizimit të suksesshëm, organizatori duhet të krijojë edh ekipin e duhur të njerëzve që angazhohen në ndeshjet e Turneut Final. Në secilën ndeshje organizatori duhet të sigurohet se i ka të mbuluara këto poste me njerëzit përkatës:

- tavolina zyrtare (mbajtësit e protokollit me përvojë në garat e seniorëve)
- mbajtësit e statistikës (së paku dy mbajtës të statistikës në secilën ndeshje)
- spikeri oficiel
- tekniku i zërimit
- ekipi mjekësor (ekipi mjekësor duhet të jetë i vendosur në lokacion të përshtatshëm për ndërhyrje të shpejtë dhe dalje të shpejtë nga salla në rast nevoje)
- sigurimi (caktimi i personave për sigurim fizik bëhet në bazë të vlerësimit të Komesarit për Siguri)

2.3 Personat zyrtarë të FBK-së të përfshirë në organizim

Me të caktuar të obligimeve të organizatorit të Turneut Final, FBK-ja obligohet që të vë në dispozicion një pjesë të personelit të vet me qëllim të mbarëvajtjes së Turneut Final. Personat e caktuar nga zyra e FBK-së obligohen që të komunikojnë në vazhdimësi me KO dhe të vendosin në koordinim për çështjet ose problemet që mund të paraqiten para dhe gjatë Turneut Final.

2.4 Obligimet ndaj shërbimeve emergjente dhe të sigurisë

Organizatori është i obliguar që të lajmërojë Policinë më së voni 72 orë para fillimit të turneut final për orarin e ndeshjeve dhe detajet organizative të turneut.
Pas lajmërimit të Turneut Final në organet përkatëse të Policisë, po jo më vonë se tre ditë para fillimit të Turneut Final, Menaxheri i Turneut dhe Komesari për Siguri obligohen që të mbajnë një takim me zyrtarët e Policisë dhe te koordinojnë veprimet e sigurisë.

Në rast të kërkesë së Policisë, organizatori është i obliguar që të lajmërojë edhe brigadën lokale të zjarrfikësve ma pajisje të plota për shuarje të zjarrit dhe asistim të evakuimit.
Organizatori obligohet që të ketë në dispozicion gjatë Turneut Final ekipin mjekësor të një klinike publike ose private për intervenime urgjente. Ekipi mjekësor duhet të jetë i pajisur me mjet transportues mjekësor, barelë imobilizuese, oksigjen, defibrilator dhe pajisjet tjera për ndihmën e parë.
Personat përgjegjës për siguri nuk guxojnë të lejojnë qasje në sektorin VIP personave të paautorizuar dhe pa akreditimet përkatëse për VIP.

3 Salla

Temperatura minimale ne sallë gjatë zhvillimit të ndeshjeve të Turneut Final duhet të jetë 10° Celzius.

3.1 Zhveshtoret

Salla ku zhvillohet Turneu Final duhet të ketë në dispozicion së paku 2 zhveshtore funksionale që duhet të përmbajnë ndër të tjera:
- Banka ose ulëse të veçanta për së paku 12 lojtarë me së paku 24 varëse
- Së paku tri dush kabina me numër përkatëse të tualeteve
- Krevat për nevoja fizioterapie (e preferueshme)
- Mundësi të mbylljes me çelës të derës së zhveshtores për qëllime sigurie

Përveç dy zhveshtoreve për ekipet, organizatori duhet të sigurojë edhe së paku një zhveshtore për personat zyrtarë që duhet të përmbajnë ndër të tjera:
- Banka ose ulëse për katër persona me së paku katër varëse
- Një dush kabinë me toalet
- Mundësi të mbylljes me çelës të derës së zhveshtores për qëllime sigurie

3.2 Tavolina zyrtare

Kosovo Basketball Federation, Lagja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000 Prishtina Kosovo.
www.basketbolli.com email: info@basketbolli.com tel: +381 38 704 101; mob: 00386 49 738 080

Qendra Tregtare ETC Trading Center
IPKO
TEB BNP PARIBAS JOINT VENTURE
BAKER TILLY KOSOVO
SWISS DIAMOND HOTEL Prishtina
TREGTIA www.tregtia.net
digi prin

Salla duhet të ketë në dispozicion tavolinën zyrtare ku duhet të akomodohen 7 persona (dy mbajtës të statistikës, mbajtësi i kohës, mbajtësi i 24 sekondëshit, vëzhguesi, procesmbajtësi dhe spikeri oficiel). Tavolina zyrtare duhet të jetë e ngritur nga fusha e lojës (të jetë ne vendosur në një platformë), të ketë në dispozicion së paku pesë kyçje në rrjetin elektrik dhe përveç rrjetit Wi-Fi afër tavolinës zyrtare duhet të ketë edhe internet me kabllo (lidhja LAN me minimum 1MB Dl/Up).

3.3 Zyrat

Në objektin e sallës, afër fushës së lojës një zyrë duhet të vihet në dispozicion të FBK-së dhe zyrtarëve të saj. Zyra duhet të përmbajë ndër të tjera:
- Tavolinë dhe ulëse për së paku 8 persona
- Televizor të lidhur me dvd player
- Së paku pesë kyçje në rrjetin elektrik
- Kopjuter
- Printer laserik
- Mundësi të mbylljes me çelës të derës së zyrës për qëllime sigurie

3.4 Tribuna VIP
Organizatori është i obliguar që në pjesën qendrore të sallës në parter, përballë tavolinës zyrtare të vendosë 100 ulëse për mysafirët VIP. Në këtë pjesë mund të ulen vetëm bartësit e akreditimeve VIP ose biletave VIP. Kjo pjesë e sallës duhet të mbikëqyret nga së paku dy pjesëtarë të sigurimit të ndeshjeve. Është e preferueshme që mysafirët VIP të kenë qasje/hyrje në sallë të ndryshme nga hyrja për publikun dhe të kenë qasje të lehtë në hapësirat ku zhvillohen koktejet dhe pritjet pas takimeve dhe në pauza.

3.5 Vendet e rezervuara për ekipet pjesëmarrëse

Organizatori që të ndajë një hapësirë të veçantë në tribuna për pjesëtarët e ekipeve pjesëmarrëse në Turneun Final. Kjo pjesë e tribunës duhet të ketë kapacitet prej 60 ulësesh dhe në të duhet të kenë qasje pjesëtarët e ekipeve pjesëmarrëse në Turneun Final të cilët pajisen me bileta të veçante ose me akreditime të veçanta.

3.6 Tribuna për gazetarë

Organizatori obligohet që gazetarët e akredituar për të mbuluar Turneun Final ti vendosë në një hapësirë të veçantë – lozhën e gazetarëve. Lozha e gazetarëve, nëse nuk është hapësirë e veçantë e ndarë nga tribuna e shikuesve, duhet të jetë e vendosur prapa njërit kosh në anën e bankave të ekipeve. Lozha për gazetarë duhet të ketë hapësirë për ulje

Qendra Tregtare ETC Trading Center
IPKO
TEB BNP PARIBAS JOINT VENTURE
BAKER TILLY KOSOVO
SWISS DIAMOND HOTEL Prishtina
TREGTIA www.tregtia.net
digi prin

dhe mbajtje të shënimeve për 20 persona dhe kyçja të mjaftueshme në energji elektrike. Në këtë lozhë mund të kenë qasje vetëm gazetarët e akredituar për mbulimin e Turneut Final.
Organizatori obligohet të sigurojë kushte të veçanta për stacionin televiziv kombëtar që bën transmetimin e ndeshjeve të Turneut Final. Transmetuesit të ndeshjes duhet ti sigurohet qasje e pakufizuar e kameramanëve në fushën e lojës.
Për fotoreporterët dhe kameramanët e televizioneve jo transmetuese duhet të rezervohen hapësira të veçanta në sallë, të ndryshme nga ato të gazetarëve, pa cenuar hapësirën për televizionin transmetues.

3.7 Press qendra

Organizatori obligohet që të rezervojë një hapësirë në sallë (mix zone) ku gazetarët dhe kameramanët mund të marrin deklarata nga lojtarët dhe trajnerët si dhe një hapësirë tjetër të veçante për konferenca për media. Hapësira konferencave për media duhet të ketë në tërë prapavijën banerin me sponsorët e Kupës së Kosovës sipas modelit të FIBA Evropës të paraqitur më poshtë, tavolinë dhe ulëse për pesë pjesëmarrës në konferencë, ulëse të mjaftueshme për 20 gazetarë, Wi-Fi internet me shpejtësi të upload-it minimum 2 Mb/s dhe kyçje të mjaftueshme në rrjetin elektrik.

Size: 500x200 cm
Print: full colour
Scale: 1:10
Scale reduction: 32%

Sliding concept - Aligned logos - 1 sponsor category

4 Akreditimet dhe biletat

Organizatori obligohet që të punojë akreditimet dhe të bëjë shpërndarjen e tyre personave përkatës më së voni 12 orë para fillimit të Turneut Final. Akreditimet duhet të kenë madhësi të njëjtë – standarde dhe dizajni I tyre duhet të miratohet nga FBK.

Kosovo Basketball Federation, Lagja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000 Prishtina Kosovo.
www.basketbolli.com email: info@basketbolli.com tel: +381 38 704 101; mob: 00386 49 738 080

Qendra Tregtare ETC Trading Center
IPKO
TEB
BNP PARIBAS JOINT VENTURE
BAKER TILLY KOSOVO
SWISS DIAMOND HOTEL Prishtina
TREGTIA www.tregtia.net
digi prin

Organizatori obligohet që secilin ekip pjesëmarrës ta pajisë me 24 akreditime te llojit "TEAM". Organizatori obligohet që FBK-në ta pajisë me 6 akreditime "STAFF" dhe 50 akreditime "VIP.
Organizatori obligohet që secilin medium të akredituar ta pajisë me 2 akreditime dhe atë gazetarët me akreditimin e llojit "PRESS" dhe kameramanët e foto reporterët me akreditimin "TV/FOTO". Stafi i televizionit nacional që bën transmetimin e ndeshjes pajiset me akreditime të veçanta të llojit "BROADCASTER".
Organizatori obligohet që të gjithë personat e përfshirë në organizimin e Turneut Final ti pajisë me akreditimet e llojit "STAFF", kurse personat përgjegjës për sigurim fizik ti pajisë me akreditimet e llojit "SECURITY".
Dizajni i biletave bëhet nga organizatori dhe miratohet nga FBK. Organizatori obligohet që në rast të kërkesës nga zyrtarët e lartë të shtetit (MRKS, Qeveria, Presidenca ose Komuna ku zhvillohet Turneu Final) të rezervojë deri në 10 VIP ftesa/akreditime për përfaqësues institucionesh.

5 Ceremonia e hapjes dhe e mbylljes së Turneut Final

5.1 Ceremonia e hapjes së Turneut Final

Ceremonia e hapjes së Turneut Final fillon 15 minuta para fillimit të ndeshjes së parë të turneut dhe nuk guxon të zgjasë më shumë se 9 minuta. Ceremonia e hapjes duhet të fillojë me intonimin e himnit të Republikës së Kosovës. Në ceremoninë e hapjes mund të mbajnë fjalim më së shumti 2 persona, prej të cilëve I dyti e shpall turneun zyrtarisht të hapur.
Skenari i ceremonisë së hapjes hartohet nga organizatori dhe miratohet nga FBK, më së voni 24 orë para fillimit të Turneut Final.

5.2 Ceremonia e mbylljes së Turneut Final

Ceremonia e mbylljes së Turneut Final fillon menjëherë pas përfundimit të ndeshjes finale të turneut. Organizatori duhet të përgatisë skenarin (jo më të gjatë se 5 minuta) dhe ta dërgojë për miratim nga FBK më së voni 24 orë para ndeshjes finale. Është në diskrecionin e FBK-së të caktojë personat që bëjnë dorëzimin e medaljeve dhe trofeve pas përfundimit të finales.
Organizatori është i obliguar që për fituesin e Kupës të montojë podiumin në sallë, që duhet të montohet menjëherë pas përfundimit të ndeshjes, në afat prej 2 minutash.

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

6 Marketingu dhe promocioni

Organizatori mban të drejtë ne realizimit të fitimit nga shitja e biletave, çmimin e të cilave e cakton vetë, me miratimin e FBK-së. Organizatori obligohet të sigurojë transmetim të drejtpërdrejtë të ndeshjeve të turneut final nga një televizion nacional. Organizatori obligohet që të ndajë hapësirën reklamuese për sponsorin e Kupës dhe sponsorët

e FBK-së në transmetimin televiziv, sipas kontratës që e nënshkruan me FBK-në, organizatori obligohet që të ndajë edhe pjesë të caktuara të hapësirës reklamuese në sallë për sponsorin e Kupës dhe sponsorët e FBK-së, sipas kontratës së nënshkruar me FBK-në dhe diagramit të paraqitur më poshtë.

6.1 Brandingu i sallës

Organizatori mban të drejtë ne brandingut të sallës përderisa i përmbahet dispozitave të kontratës që nënshkruan me FBK-në dhe diagramit të paraqitur më poshtë. Organizatori preferohet që në pjesën ballore të sigurojë mekanizëm të reklamave me ndriçim LED dhe atë 12 blloqe të dimensioneve 3mx1m. Media plani I reklamave në mekanizmin me ndriçim LED caktohet bashkërisht nga organizatori dhe FBK dhe FBK-së i takon 60% e hapësirës – kohës reklamuese në reklamat në sallë.
Në rast se organizatori nuk siguron reklama LED, brandingu i sallës bëhet me banerë të dimensioneve 3mx1m, shpërndarja e të cilëve bëhet sipas diagramit të paraqitur më poshtë.

Dizajni i banerëve dhe reklamave duhet të miratohet nga FBK.
Organizatori mban të drejtën e vendosjes së reklamave jashtë sallës (billboarda, posterë reklama lëvizëse etj), të cilat e dizajnon vetë me miratimin e FBK-së.

7 Mediat

<u>7.1 Konferencat për shtyp</u>

Organizatori obligohet të organizojë konferencat për shtyp. Konferenca e parë duhet të mbahet në afat prej 72 orësh pas fitimit të së drejtës për organizim të Turneut Final.
Konferenca e dytë duhet të mbahet më së voni 24 orë para fillimit të Turneut Final. Në këtë konferencë duhet të bëhen publike detajet organizative dhe çmimet e biletave si dhe duhet të marrin pjesë kapitenët e ekipeve pjesëmarrëse. Shpenzimet e udhëtimit të kapitenëve të ekipeve (në rast se vijnë nga qytete të ndryshme) i bartë organizatori. Organizatori obligohet që të organizojë konferenca për shtyp pas të secilës ndeshje të Turneut Final, jo më vonë se 20 minuta pas përfundimit të ndeshjes përkatëse, në hapësirë ne veçantë të caktuar për konferenca për media.

7.2 Broshurat e Turneut Final

Organizatori obligohet që të përgatisë dhe të printojë broshurën e Turneut Final. Përmbajtja e broshurës përgatitet nga organizatori me miratimin e FBK-së. Broshura duhet të përmbajë këto elemente themelore:
- informatat për ekipet dhe lojtarët pjesëmarrës
- informatat për qytetin dhe sallën ku zhvillohet Turneu Final
- listën e fituesve të mëhershëm të Kupës dhe historikun e garës
- listën dhe logot e sponsorëve të garës së Kupës së Kosovës dhe Turneut Final

Broshura duhet të printohet në së paku 400 ekzemplarë dhe është e obligueshme që të distribuohet për të gjithë mysafirët VIP dhe për gazetarët e akredituar.

BNP PARIBAS JOINT VENTURE